



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA SKRAPAR

Data 20.04.2016

Tema: Degjese e Trete Publike. Hartimi I Planit te Pergjithshem Vendore. Faza e II-te.

Sot me date 20/04/2016, ora 11:00 ne nje nga sallat e Kinemase se qytetit te Corovodes u mbajt Degjese e Trete Publike rreth PPV te Bashkise Skrapar. Fjalën e hapjes se ketij takimi e mori perfaqesuesi I firmes GAIA Z.Elton Toska.Me fjalën e tij falenderoi te gjithë pjesmarresit,perfaqesuesit e AKPT qe ishin te pranishem si edhe stafin e Bashkise Skrapar Drejtorin e Planifikim Territorit z.Bledar Methoxha,Specialiste Ne Zyren e Urbanistikes znj.Sonila Hysenbelli e IT znj.Arisa Hldersha per bashkepunimin.Pas falenderimeve te bera z.Toska,nisi me prezantimin e fazes se dyte te hartimit te planit te pergjithshem vendore te Bashkise Skrapar. Gjate ketij prezantimi do te trajtojme : - Konkluzionet e arritura nga perfundimi I fazes se I-re. -Raport te perfundimeve te pergjithshme per 5- sistemet territoriale (natyrore,ujore,bujqesore, urbane dhe infrastructure).

-Përcaktimi i nevojave të Bashkisë nëpërmjet Analizës SWOT për çdo sistem territorial (pikat e forta,pikat e dobëta,mundësitë e rreziqet).

-Vizioni I Bashkise

-Planet e veprimit dhe projektet Pilot

- Analiza Swot e Sistemit Territorial Natyror. 1.Mjedis i pasur natyror (ujra, minerale) me vlera të larta ekologjike, estetike,shkencore dhe ekonomike, si dhe me shumë mundësi promovimi dhe zhvillimin, madje edhe në nivel ndërkombëtar.

Mjedis i pastër dhe i qetë. Parku Kombëtar I Tomorrit dhe Kanionet e Osumit pasuri e madhe natyrore per Bashkine Skrapar.

- Degradimi i biodiversitetit për shkak të gjuetisë së paligjshme të zogjve të egër dhe gjitarëve të mëdhenj. Mundësi shumë e mirë zhvillimi I turizmit alternative bazuar ne mjedisin natyror.

- Analiza Swot e Sistemit Territorial Ujor. Burime te pasura ujore. Mbulimi nevojave te furnizimit me ujit të Bashkisë dhe më gjerë, si dhe prodhimi energjisë elektrike nga burimet e Guakut dhe Bogovës.

Mundesi per mbulimin e furnizimit te gjithe zones me uje. Pamundësia e bashkëpunimi me Bashkitë fqinje dhe institucionet e shoqërisë civile në çështjet që kërkojnë bashkëpunim ndër-komunal, të tilla si menaxhimi i integruar i burimeve ujore .

Analiza Swot e Sistemit Territorial Bujqesor. Ekzistenca e llojshmerise te bimeve mjekesore aromatike. Produkte te shumta blegtorale.Munngesa e infrastructures sjell largimin dhe humbje ne keto arritje. Mundesi per plotesimin e kerkesave per produkte cilesore. Mund te shikohet zhvillimi I agroturizmit sepse produktet jane shume te mira. Produkti ka nevoje per ambalazhim.Rrezik ne pershtatje me kohen.

Analiza Swot e Sistemit Territorial Urban. Ka nje fluks njerezish ne sezonin veror.Shikohet nje interes per arsimin. Ekzistenca e monumenteve natyrore te reklamohen me shume. Baxhot mund te sjellin perfitim ekonomik,duhen mbajtur. Mali I Tomorrit nje rendesi e madhe fetare. Vihet shum re nje braktisje e zonave rurale. Duhet nje permiresim I cilesise se bizneseve,si per shembull ardhja e Tap-it ka vene re nje mungese te apartamenteve cilesore. Duhet aplikuar per thithjen e instrumenteve financiare.

Analiza Swot e Sistemit Territorial Infrastrukturore. Ekzistenca e lidhjeve te dobeta midis fshatrave te Bashkise Skrapar. Ekzistojne gjurmet e nje sistemi te vjeter ujites kjo do te thote qe perderisa ka ekzistuar eshte e mundesia per nje sistemi te ri. Vendosja e 22 Hece-ve.

Vizioni i Zhvillimit Përmirësimin e standardeve e cilësisë së jetës . Menaxhimi I duhur I burimeve natyrore,promovim I bashkise,zhvillim I qendrueshem I sektoreve te bujqesise,blegtorise.

Objektivat Strategjik Rigjenerimi I ekonomise se zones,zhvillimi I turizmit alternative,zhvillim I infrastructures dhe menaxhim I burimeve natyrore.

Plani i Veprimit Bashkia Skrapar ka 35 projekte Afatgjate.Nga te cilat 9 jane me prioritare :


1. Lidhja vendosur infrastrukture Corovode-Korce,Corovode-Permet
2. Permiresimi I rrugeve Corovode-Qendra Administrative (Potom,Leshnje,Cepan,Vendreshe e Madhe) .
3. Zhvillim I qendrueshem ekonomik ne zonen hyrese te qytetit te Corovodes.

4. Ndertimi I impiantit te trajnimit te ujrave te zeza.
5. Promovimi I Identitetit turistik te Bashkise .
6. Ndertimi I lehtesirave per bujqesi dhe blegtori(Corovode,Bogove,Cepan,Vendreshe).
7. Krijimi I hapësirave argetimi ne Malin e Tomorrit.
8. Bashkia Skrapar ka nje project shume te bukur per qendren.
9. Krijimi I rruges se mjedisit natyrore dhe kulturore pergjate lumit te Tomorrices.

Vleresohet qe synimi I Bashkise Skrapar qe te gjitha projektet nuk jane perqendruar vetem ne nje zone te caktuar,por jane shtrire ne te gjithe territorin e bashkise. Kjo ishte dhe fjalia e mbylljes se fazes se II-te per "Hartimin e Planit te Pergjithshem Vendore (PPV)"per Bashkine Skrapar.

Protokolli

Arisa HIDERSHA



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT

DREJTORI

Bledar METHOXHA

